



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **UNIVERSITETI " HAXHI ZEKA " NË PEJË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	uhz-19-1816-1-2-1
Nr i brendshëm	208 19 008 121

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me pajisje muzikore për Fakultetin e Arteve, Universiteti Haxhi Zeka në Pejë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.P.T."MALI-I"& N.T.P."VLORA"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Ulqinit

(Adresa)

Mitrovicë

(Kodi postar)

/

(Numri Telefonit)

/

(Vendi)

/

(Numri i Faks-it)

Majlinda Bajraktari- drejtor

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

npt.mali-i@hotmail.com

(Adresa elektronike)

29.05.2019.

(Data e parashtrimt të kërkesës)

"MALI-I"
MITROVICË
(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/_____
(Emri i avokatit)

/_____
(Adresa e plotë)

/_____
(Numri i Telefonit)

/_____
(Numri i faks-it)

/_____
(Adresa elektronike)

/_____
(Data e parashtrimit të ankesës)

/_____
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate 08.04.2019..

Njoftimi per dhenie te kontrates nuk aplikohet

Njoftimi mbi vendimin e AK 13.05.

Afati i fundit per dorezimin e ofertav 26.04. ora 14:00

Kriter per dhenie te kontrates- Tenderi i pergjegjshem me cmim me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

N.P.T.
"MALI-I"
MITROVICE 2/4

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues se bashku me letren standarde per tenderuesin e eliminuar e kemi pranuar ne e-prokurim me 13.05.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa për ri-shqyrtim kemi parashtruar me 17.05.2019.

Vendimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit 20.05.2019.

Vendimi për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim nga AK me 20.05.2019.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 39 i UOPP- Sqarimi i tendereve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Këto terme janë përdorur shumë herë në tekstin e mëposhtëm prandaj edhe i kemi përdorur shkurtesat që kanë domethënie si në vijim:

AK- Autoritet Kontraktues

OE- Operator Ekonomik

LPP- Ligji i prokurimit publik

UOPP- Udhëzimi operativ për prokurimi publik

FDT- Fleta e te dhenave te tenderit

AK/Komisioni vlersues gjatë vlersimit të ofertave për tenderin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/Komisioni vlersues ka eliminuar kompaninë/konzorciumin tone edhe pse ne kemi plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

AK ka eliminuar kompaninë/konzorciumin tone me arsyetimin se nuk kemi paraqitur deshmi për furnizime të ngjashme sipas nenit 9.1&9.2 të FDT-se përkatësisht në vlerën 22,000.00euro, ky pretendim nuk qëndron pasi që ne kemi dorëzuar deshmi në listën e kontratave 2 furnizime të ngjashme (kontratat nr 32, 33 në listë) që total arrijnë vlerën prej 33,411.00 dhe kontrata me KK Istog e OE Vlora në vlerë prej 3916.00 dmth konzorciumi ka dorëzuar deshmi për furnizime të ngjashme në vlerë totale prej 37,327.00. dhe Lideri i konzorciumit përben me shumë se 50% të shumës së kërkuar sipas kërkesës së AK në nenin 9.1&9.2 të FDT-se.

AK bazuar në listën e kontratave të dorëzuar ka mundur që konform nenit 72 të LPP-se dhe nenit 39 të UOPP të kërkojë sqarime shtese para se të vendos për eliminimin e kompanisë sonë/konzorciumit.

Baza ligjore nëni 39 i UOPP-se

Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara Mund të kërkojnë informata sqaruese 69.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura nga AK/komisioni vlersues ka ardhë deri të eliminimi i kompanisë sonë dhe dhenia e kontratës për OE me të shtrejte dhe në këtë mënyrë nuk është respektuar kërkesa decitive e LPP përkatësisht Neni 60 që kontrata të ipet tenderuesit të përgjegjshëm me cmimin më të ulët.

Kompanisë sonë i është mohuar një fitim simbolik i paramenduar nga kjo kontratë.

Kërkojmë nga zyrtari kryesor i prokurimit të ri-emërojë komisionin vlersues dhe nën mbikëqyrjen e tij si person përgjegjës lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe kontrata të ipet kompanisë sonë si tenderi i përgjegjshëm me cmimin më të ulët.

Kërkojmë që ankesa të aprovohet si e bazuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

